

STATUT
I SHOQERISE "LAKE SHORE" sh.p.k.

DISPOZITA TE PERGJITESHME

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "LAKE SHORE " sh.p.k., eshte themeluar sipas akt themelimit dhe ketij statuti te perpiluara dhe nenshkruar nga ortaket e saj bazuar ne "Ligjin" Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";

KREU I
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

NENI 1

DATA E THEMELIMIT, EMRI DHE THEMELUESIT

Sot, më 22/06/2020 ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar

Shoqeria do te emerohet " LAKE SHORE " sh.p.k.

Themeluesit e shoqërisë janë:

- 1.- **Armando Pajtoni**, atesia Shaban, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, me date 11.08.1979 dhe banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit me nr. Personal H90811058K madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar ne cilesine e ortakut qe zoteron 1 kuote me pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise prej 33.4 %.
- 2.- **Ervis Deda**, atesia Hiqmet, shtetas shqiptar, lindur ne Elbasan, me date 26.11.1983 dhe banues ne Elbasan, mbajtes i leternjoftimit me nr. Personal I31126050U madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar ne cilesine e ortakut qe zoteron 1 kuote me pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise prej 33.3%.
- 3.- **Z.Charles Michel Bouri**, atesia Alexandre shtetas Britanik, lindur ne Londer, me date 15.07.1972 dhe banues ne Tirane me adrese te deklaruar Godina "Torre Drin", mbajtes i pasaportes britanike me Nr. 560537763, njohes i mire i gjuhës shqipe, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar ne cilesine e ortakut qe zoteron 1 kuote me pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise prej 33.3%.

NENI 2

OBJEKTI I SHOQERISE

Kryerjen e cdo veprimtarie te lejuar nga ligji shqiptar, prodhimin e betonit dhe materialeve te tjera inerte, shitjen dhe tregtimin me shumice dha pakice te materialeve te ndertimit,transportin e lendeve te para e te cdo materiali tjetër te nevojshem per realizimin e qellimit te prodhimit, ngarkim shkarkimit, transportin e mallrave per vete shoqerine dhe per te trete si dhe cdo aktivitet tjetër qe lidhet dhe eshte i nevojshem per objektin e mesiperm. Shitje-blerje pasuri te patundshme.

Projektimi dhe zbatimi i veprave ndertimore si vijon: ndertime me karakter civil dhe ekonomik, punime/germime dhe sistemime dheu, tarracime terrenesh; rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash, ndertime urash dhe konstruksione metalike, montime panelesh, ndertime rruges,asfaltme,hapje

kanalësh si dhe cdo ndertim tjetër me karakter civil dhe ekonomik. Projektimi dhe zbatimi i veprave ndertimore, rrugë të të gjitha kategorive, punime të mirembajtjes dhe të sinjalizimeve në rrugë, ndertime autostradash, pista aeroportesh dhe helikopteresh. Projektim dhe zbatim vepra arti si; ura, vepra arti mbi 10m, ndertim tunelesh rrugë rrugore dhe hekurudhore, ndertime detare, ku përfshihen ndertime portuale, bankina, basen pontile, punime thellimi dhe drenimi, punime për vepra të vecanta e punime speciale, sillose, kulla uji etj. Projektimi dhe zbatimi i ndertimeve hidraulike dhe hidroteknike, ndertim ujesjellësh, kanalizime, kanale e impiante vaditjeje. Punime mbrojtjeje të sistemit hidraulik, cimentime, etj. Ndertim impiante të trajtimit të ujit, ndertim digash, galeri tunele, ndertim diga të larta, etj. Zhvillimi dhe ndermjetesimi i projekteve për rikonstruksionin e ndermarrjeve industriale. Kryerje të veprimtarive tregtare për zbatimin, zhvillimin, menaxhimin e zonave civile, industriale, turistike, si dhe shërbimeve të tjera të ngjashme të lidhura me to. Kryerja e veprimtarive tregtare në fushën e ndertimit, për prodhim dhe shitblerje të materialeve të ndertimit. Kryerja e aktivitetit për investimin në fushën e ndertimit, në komplekse civile, turistike, industriale, sociale, komplekse të tregtimit dhe të shërbimit, bar, restorant, hoteleri etj. Pjesëmarrje në projekte ndertimore si sipërmarrës, investitor, konsulent, si dhe marrjen përsipër të menaxhimit të tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në baze të autorizimeve dhe/ose lejeve përkatëse të leshuara nga organet kompetente të fushës.

NENI 3

ADRESA E SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë Selinë e saj në Mezez, Lagja Fushe Mezez, Autostrada Tirane Durrës, Km1, Qendra Pajtoni Bussines Center, Ndertesa në Zonën Kadastrale 2679, Nr. Pasurie 66/47.

Veprimtaria e shoqërisë mund të ushtrohet duke krijuar filiale ose përfaqësi brenda dhe jashtë vendit, konform me ligjin shqiptar ose të huaj.

NENI 4

KOHEZGJATJA E SHOQËRISË

Kohezgjatja e Shoqërisë është për një periudhë të pakufizuar, periudhë e cila mund të ndryshojë me vendim të Asamblesë së Ortakëve.



KREU II **KAPITALI**

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 15,000,000 Lekë dhe i ndarë në 3 (tre) kuota, sipas pjesëmarrjes së themeluesve në kapitalin e shoqërisë në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1.- Armando Pajtoni, atesia Shaban, shtetas shqiptar, lindur në Tirane, me datë 11.08.1979 dhe banues në Tirane, mbajtës i letërnjoftimit me nr. Personal



H90811058K madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar ne cilesine e ortakut qe zoteron 1 kuote me pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise prej 33.4 %.

2.- Ervis Deda, atesia Hiqmet, shtetas shqiptar, lindur ne Elbasan, me date 26.11.1983 dhe banues ne Elbasan, mbajtes i leternjoftimit me nr. Personal I31126050U madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar ne cilesine e ortakut qe zoteron 1 kuote me pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise prej 33.3%.

3.- Z.Charles Michel Bouri, atesia Alexandre shtetas Britanik, lindur ne Londer, me date 15.07.1972 dhe banues ne Tirane me adrese te deklaruar Godina "Torre Drin", mbajtes i pasaportes britanike me Nr. 560537763, njohes i mire i gjuhes shqipe, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar ne cilesine e ortakut qe zoteron 1 kuote me pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise prej 33.3%.

NENI 6

ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Mbledhja e asamblese se ortakeve eshte organi vendimmarres per rritjen dhe zvogelimin e kapitalit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë, por vete ortaku pranon rivlersimin e pjeses se tij takuese ne shoqeri ne porporcion me rritjen e kapitalit .

Zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

NENI 7

TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme tek te trete, me kusht

respektimin e procedurave ligjore dhe respektimin e ushtrimit se te drejtes se parablerjes mes ortakeve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III **ORGANET VENDIMMARRESE, DREJTUESE DHE STRUKTURORE TE SHOQERISE**

NENI 8

ORGANET VENDIM-MARRESE DHE DREJTUESE TE SHOQERISE

Shoqeria eshte e organizuar ne organet e meposhteme:

1- Asambleja e Ortakeve Te Shoqerise

2- Administratori

Asambleja e Ortakeve eshte organi me i larte vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme ne perputhje me nenin 10 dhe 11 te statutit:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- dh) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë dhe shperndarja e fitimit/humbjes vjetore;
- g) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- h) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- j) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- k) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- l) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- m) njeherazi mund te vendoset mbi lejimin ose marrjen pjese (hyrjen) ne veprimtari te perbashketa me shoqeri te tjera shqiptare ose te huaja edhe kur ato nuk kane objekt

aktiviteti ate te shoqerise.

Ortakët mund të përfaqësohen në asamblenë e përgjithshme, nga një person i tretë me autorizimin perkates.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

NENI 9

MËNYRA E THIRRJES SE Mbledhjes SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 5 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 10

KUORUMI

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 51% për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtarët dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se tre te katertat ose 75% te numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 11

MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e përgjithshme vendos me 75% ose me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës ceshtjet e meposhteme:

1. për ndryshimin e statutit
- 2.zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar

3. shpërndarjen e fitimeve

4. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, sipas nenit 10 pika 1, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasyqruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

NENI 12

PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

NENI 13

ADMINISTRIMI

1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

3) Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i shoqërisë për një afat 5 vjecar nga data e regjistrimit të kësaj shoqërie pranë QKB-se.

- **Z. Ervis Deda, atesia Hiqmet, shtetas shqiptar, lindur ne Elbasan, me date 26.11.1983 dhe banues ne Elbasan, mbajtes i leternjofitimit me nr. Personal I31126050U madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.**

NENI 14

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori eshte organi drejtuesi i shoqerise i cili ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme, te kryeje te gjitha veprimet bankare me cdo banke te nivelit te dyte, pa asnje kufizim ;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare, te nenshkruaje kontrata ,noteriale ose jo, apo cdo lloj akti tjetër te domosdoshem qe lidhet me aktivitetin e shoqeriser pa kufizim;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatiti dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori eshte I detyruar te therasi Asamblene e Pergjitheshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 15

PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i

ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

1.) administratori detyrohet:

a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Ne menyre te vecante, por pa u kufizuar ne to, administratori është i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundershkrim me dispozitat e ligjit per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, kryen veprime e meposhteme:

a) u kthen ortakeve kontributet;

b) u paguan ortakeve interesa apo dividende;

c) u shperndan aktivet e shoqerise;

ç) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare kur ne base te gjendjes financiare duhet te parashikohej qe shoqeria nuk kishte aftesi pagueuse per te shlyer detyrimet;

d) jep kredi;

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e

nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV
VITI FINANCIAR-EKSPERTET

NENI 16
VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqërise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

NENI 17
EKSPERTET

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqërise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

KREU V
PRISHJA -RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

NENI 18
PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Shperndarja ose prishja e shoqërise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- e) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqërise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqëri ne likuidim e siper " .

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

NENI 19

RIORGANIZMI I SHOQËRISË BASHKIMI-NDARJA

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

NENI 20

BAZA LIGJORE

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

NENI 21


MOSMARRËVESHJET

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jete kompetente Gjykata Shqiptar.


Ky Statut nënshkruhet me vullnet të lire në 3 kopje identike në gjuhën shqipe, në prani të perkthyeses dhe secili nga ortakët do të marrë një kopje.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

- **Z.Armando PAJTONI**



- **Z.Ervis DEDA**



- **Z.Charles Michael BOURI**

